

16.12.2021

Fletëpalosje: Vetë-testimi i fëmijëve

Më shumë teste për më pak Corona

Të dashur prindër,

me këtë fletëpalosje dëshirojmë t'ju informojmë se pse vetë-testimet te fëmijët tuaj janë të dobishme.

Pse një vetë-testim i fëmijës suaj është i rëndësishëm?

Ndihmoni në kontrollin e Koronavirusit dhe përdorni rregullisht vetë-testet falas për fëmijët tuaj. Sidomos në kohën e udhëtimeve, duhet të jeni veçanërisht të vëmendshëm dhe të kujdesshëm për të mbrojtur fëmijët tuaj dhe fëmijët e tjerë.

Testet u japin fëmijëve tuaj siguri në grup.

Vetë-testimet janë një ndihmë e dobishme për të identifikuar infeksionin në një fazë të hershme dhe për të shmangur përhapjen e infeksioneve te mëtejshme.

Një vetë-test është gjithmonë një **raport momental** dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të bëni vetë-testimin e fëmijëve tuaj rregullisht, edhe nëse ai ose ajo nuk ka asnjë simptomë.

Kështu mund të ndihmoni që t'i mbani fëmijët tuaj dhe të tjerët të sigurt.



Cilat vetë-teste do të ofrohen në qendrat e fëmijëve dhe familjes?

Adresa postare
KiTa Bremen
Auf der Muggenburg 5
28217 Bremen

Telefon
0421-361 5700
Telefax
0421-361 59771
E-Mail
office@kita.bremen.de
Internet
www.kita.bremen.de


Tram
Linie 3,5
Stacioni
Eduard-Schopf-Allee

KiTa Bremen
Në pronësi
të komunës
Bremen
Menaxher
Wolfgang Bahlmann
Zv. menaxhere
Petra Zschüntzsch

Deutsche Bundesbank
Filiale Hannover
IBAN
DE09 2500 0000
0025 1015 66
BIC
MARKDEF1250

Nr. i taksës
60-100-07915

USt-IdNr.
DE322325940



Vetë-testimet janë të miratuara për fëmijët janë vullnetare dhe janë përzgjedhur nën mbikqyrjen shkencore. Ato nuk janë të rrezikshëm për fëmijët. Provëza merret në zgavrën e përparme të hundës.

Në qendrat e fëmijëve dhe familjeve ofrohen pa pagesë vetë-testimet me provëza hundore.

Si ta kryej unë saktë testin?

Ju lutem lexoni udhëzimet përkatëse përpara se të kryeni testin

dhe kryeni testin tek fëmija juaj me duar të lara.

Tamponët e hundës janë veçanërisht të përshtatshme për fëmijët. Tamponi I pambukut futet 1-2 cm thellë në hundë.

Në faqen kryesore të Senatores për Fëmijët dhe Arsimin, do të gjeni në pjesën e informacioneve për koronën një video shpjeguese se si të kryeni testin për kopshtin.

Sugjerim:

Videon mund ta gjeni në

<https://www.bildung.bremen.de/Corona-Informationseite/>

Kita und Schulbetrieb/Kitas/Testungen/Wie funktioniert der Test für Kita-Kinder? Jarno dhe Katja e shpjegojnë




Si mund ta bej më të lehtë vetë-testimin për fëmijën tim?

Krijoni një atmosferë relaksuese për ju dhe fëmijën tuaj. Shpjegojini fëmijës suaj hapat individualë të testit në mënyrë që ai të kuptojë se çfarë do ndodhi. Ju lutem mos testoni kundër vullnetit të fëmijës. Tregoni fëmijës suaj çdo herë se çfarë do të bëni më pas. Është mirë që paraprakisht ta provoni testin së bashku si një lojë. Ose mund ti tregoni fëmijës suaj se si funksionon testi te vetja juaj. Ndoshta fëmija juaj mund ta luaj fillimisht testin me një kukull ose një lodër tjetër.



Sa shpesh duhet të bëhen vetë-testimet e koronës tek fëmija juaj?



Vetë-testimet kryhen në shtëpi të hënave dhe të enjteve në mëngjes para fillimit të kopshtit.

Nëse e keni harruar testin në shtëpi, keni mundësinë, si përjashtim, ta kryeni testin në Qendrën e Fëmijëve dhe Familjes.

Është shumë e rëndësishme që të kryhen rregullisht vetë-testimet për të zbuluar infeksionet në një fazë të hershme dhe për të mbrojtur fëmijët në kohën e duhur.

Si të silllem pas një rezultati pozitiv të testit?

Nëse rezultati është pozitiv, fëmija juaj nuk lejohet të vijë në qendrën e fëmijëve dhe të familjes dhe duhet të qëndrojë në shtëpi. Ju lutem njoftoni menjëherë qendrën tuaj për fëmijët dhe familjen me telefon. Më pas ju lutem caktoni një takim për një test PCR për të kontrolluar rezultatin. Për ta bërë këtë telefononi 361 10100. Nëse rezultati PCR është pozitiv, ju lutem njoftoni qendrën tuaj të fëmijëve dhe familjes. Pastaj fëmija juaj duhet të rrijë në izolim. Ju duhet të testoheni edhe vetë. Nëse rezultati është negativ, fëmija juaj mund të vizitojë sërish qendrën e fëmijëve dhe familjes.



Si të silllem pas një rezultati negativ të testit?

Nëse rezultati është negativ, fëmija juaj mund të vizitojë qendrën e fëmijëve dhe familjes. Nëse keni dyshime për rezultatin e testit ose nëse testi është i pavlefshëm, mund ta përsërisni testin edhe njëherë.

Ju lutem vini re se një vetë-testim është thjesht një **raport momental** dhe duhet të përsëritet rregullisht të hënave dhe enjteve.

Sugjerim

Nëse nuk dëshironi që ta bëni vetë testin tek fëmija juaj, mund ta testoni fëmijën tuaj pa pagesë në një qendër testimi. Ose kontaktoni pediatrin/en tuaj.